Programi për Menaxhimin e Sistemit Informativ Mjedisor 2023-2027



Prishtinë, 2022

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINORDHE INFRASTRUKUTRËS
MINISTARSTVO SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I IFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA E KOSOVËS PËR MBROJTJEN E MJEDISIT	**KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE**	**KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY**

Programi për Menaxhimin e Sistemit Informativ Mjedisor 2023-2027

Prishtinë 2022

Në përputhje me Nenet 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2016 për Sistemin e Informimit Mjedisor, në përputhje me nenin 52 të Ligjit nr. 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e saj, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, ka rishikuar dhe përgatitur "Programin për Menaxhimin e Sistemit Informativ Mjedisor të Republikës së Kosovës 2023-2027".

Përmbajtja

Hyrje

1. Qëllimi, Parimet dhe Rëndësia e SIM

1.1. Qëllimi, objektivat dhe përmbajtja e programit për menaxhimin e SIM 5

1.2. Parimet themelore për mënyrën e mbajtjes dhe mirëmbajtjes së programit për menaxhimin e SIM 6

1.3. Rëndësia e SIM 7

2. Korniza ligjore dhe Institucionale për SIM 9

3. Struktura dhe organizimi i SIM 14

3.1. Grupet themelore të SIM 14

3.2. Të dhënat dhe informatat për SIM 16

4. Palët e interesit 22

4.1. Roli i AMMK në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e SIM 22

4.2. Institucionet prodhuese të të dhënave mjedisore 23

4.3. Shfrytëzuesit e të dhënave të SIM 26

5. Ndërlidhja me sisteme tjera informative dhe burimet aktuale të të dhënave për SIM 28

5.1. Ndërlidhja me Sistemet tjera Informative 28

5.2. Burimet aktuale elektronike të të dhënave për SIM 29

6. Aktivitetet për Zhvillimin dhe mirëmbajtjen e SIM 32

6.1. Vlerësimi i nevojave 2023-2027 32

7. Shtojcat 34

7.1. Struktura skematike e SIM 34

7.2. Lista e shkurtesave 35

7.3. Lista e tabelave 37

Hyrje

Programi për menaxhimin e Sistemit Informativ Mjedisor të Republikës së Kosovës për periudhën 2023-2027 (në vazhdim të dokumentit Programi për menaxhimin e SIM), është dokument i përgatitur nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive që ka ky institucion dhe si obligim ligjor që del nga Udhëzimi Administrativ për Sistemin Informativ Mjedisor.

Programi për menaxhimin e SIM, është një nga dokumentet bazike operative për funksionalizimin dhe menaxhimin e Sistemit Informativ Mjedisor dhe hartimi i tij është I mbështetur në nenin 6 pika 1 të Udhëzimi Administrativ për Sistemin Informativ Mjedisor dhe nenit 7 të këtij udhëzimi dhe në nenin 52 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit.

Dokumenti ka marrë për bazë edhe akte tjera ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë funksionimin e Sistemit Informativ Mjedisor, procesin e prodhimit dhe përpunimit të të dhënave mjedisore për sektorë të caktuar mjedisor si dhe përgjegjësitë e institucioneve relevante sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Ky dokument ka marrë për bazë po ashtu edhe dispozitat ligjore që dalin nga ligjet tjera relevante si Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (nenet 52 dhe 60), Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (neni 72), Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja (nenet 25 dhe 26), Ligji për Mbeturinat (neni 14), Ligji nr. 04/L-197 për kemikate (neni 15), Ligji për Ujërat e Kosovës (neni 81) dhe Ligji Nr. 02/L-102 për mbrojtje nga zhurma (neni 9).

1. Qëllimi, Parimet dhe Rëndësia e SIM

1.1. Qëllimi, objektivat dhe përmbajtja e programit për menaxhimin e SIM

Qëllimi primar i këtij programi është të mundësojë: mbledhjen, përpunimin, shkëmbimin dhe shfrytëzimit e të dhënave për gjendjen e mjedisit në Republikën e Kosovës, përmes një sistemi modern dhe efikas në nivelin nacional, që do të ofrojë një pasqyre reale të gjendjes së mjedisit dhe problemeve kryesore mjedisore.

Përmes këtij sistemi po ashtu do të mundësohet përcjellja e gjendjes së mjedisit dhe trendëve të zhvillimeve mjedisore, analiza, vlerësimi dhe raportimi real për gjendjen e mjedisit në nivel vendi me qëllim të hartimit dhe miratimit të vendimeve strategjike nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për sektorin e mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.

Nga ky sistem do të sigurohen edhe të dhëna dhe analiza të nevojshme mjedisore edhe në kuadër të përmbushjes së obligimeve dhe standardeve mjedisore në procesin e integrimeve evropiane dhe bashkëpunimit me institucionet mjedisore të Bashkimit Evropian.

Objektivat kryesore të dokumentit janë:

- Avancimi i sistemit informativ mjedisor dhe digjitalizimi i tij;
- Përmirësimi i sistemit për monitorimin dhe raportimin e gjendjes së mjedisit përmes lehtësimit të procesit të mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave;
- Përmirësimi i informimit të politkëbërsve, publikut të gjerë dhe grupeve tjera të interesit me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe vlerësimit më të mirë të nevojave për ndërmarrjen e masave për përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

Përmbajtja e Programit për menaxhimin e SIM është e përcaktuar në nenin 7 të Udhëzimit Administrative për SIM, ku është e specifikuar që programi për menaxhimin e SIM duhet të përmbajë:

- ✓ organizimin, mënyrën e mbajtjes dhe mirëmbajtjen së SIM.
- ✓ listën e institucioneve që obligohen për dhënien e informative dhe mënyrën e dorëzimit të të dhënave sipas seksioneve tematike dhe nën-seksioneve përkatëse,
- ✓ mënyra dhe afatet kohore për dorëzimin e të dhënave dhe informatave për mjedisin,
- ✓ mënyrën e shfrytëzimit të të dhënave dhe informatave për mjedisin,
- ✓ vlerësimi i burimeve të nevojshme.
- ✓ masat dhe veprimet për seksionet tematike dhe nën-seksionet përkatëse.

1.2. Parimet themelore për mënyrën e mbajtjes dhe mirëmbajtjes së programit për menaxhimin e SIM

Menaxhimi dhe administrimi me Sistemin Informativ Mjedisor do të jetë i bazuar mbi këto parime themelore.

- **Siguria** - Masat për mbrojtjen maksimale - konfidencialitetin e materialeve dhe dokumenteve, aplikimi i sigurisë së të dhënave, kontrollit dhe sigurisë së qasjes;
- **Kontrolli** - I organizuar në mënyrë hierarkike dhe i shpërndarë për të mbështetur shërbimet dhe punët- nga niveli qendror deri tek niveli më i ulët. SIM do të përfshijë edhe mënyrën automatike për të kontrolluar lidhjet e vdekura si dhe krijimin e një grupi pune ndërdisiplinore për kontrollin dhe koordinimin e cilësisë. Një vetëvlerësim i SIM të do të jetë pjesë e rregullt e kontrollit të cilësisë dhe qeverisjes. Në funksion të kontrollit dhe cilësisë do të jetë edhe përfshirja e të dhënave për burimet e të dhënave që janë pjesë e SIM.
- **Thjeshtësia -** Strukturë funksionale dhe e thjeshtëzuar- Përmbajtje logjike e temave prioritare dhe kategorive të shërbimeve.

- **Transparenca -** Monitorimi transparent i proceseve dhe procedurave, duke ofruar informata për gjendjen aktuale të të dhënave, gjendjen e mëparshme të të dhënave dhe procesin e ndryshimit të tyre.
- **Përdorimi -** Të jetë i hapur për përdorim nga grupe të ndryshme të përdoruesve si persona fizikë, personat juridikë dhe organet e administratës publike, duke iu përshtatur kërkesave dhe nevojave të secilit grup.
- **Fleksibiliteti dhe përshtatshmëria** - Mundësia për zbatimin e ndryshimeve në mënyrë të të thjeshtë dhe të shpejtë të strukturës dhe përmbajtjes së sistemit.
- **I personalizuar dhe në përdorim të të gjithëve -** Mundësi për të ofruar përdorim të personalizuar elektronike dhe raporte të personalizuara për çdo individ, varësisht nga kërkesat e tyre, pa marrë parasysh a është një person fizik, person juridik ose punonjës i administratës publike.
- **Në një dritare -** Të gjitha informatat e nevojshme dhe komunikimit për nevojat e çdo përdoruesi të kenë mundësinë për të qenë të qasshme në mënyrë të centralizuar dhe digjitale. Portali kryesor i të dhënave do të ketë një lidhje të qartë në portalin dhe faqet tjera të internetit. Të gjitha këto burime të të dhënave do të jenë pjesë e SIM.
- **Në çdo kohë, në çdo vend -** Disponushmëria dhe sigurimi i shërbimit për përdoruesit në çdo kohë nga çdo vend.
- **I qasshëm -** Mundësia e lidhjes së portalit me të gjitha sistemet e informacionit dhe shërbimet e ueb-orientuara në kuadër të administratës publike pavarësisht teknologjisë së aplikuar dhe platformës. Duke përfshirë po ashtu mundësinë e lidhjes me të dhënat hapësinore aty ato janë në dispozicion.
- **I dizajnuar** - Pamje e pranueshme vizuale dhe me dizajn atraktiv për gjithë sistemin.
- **Gjithëpërfshirës**- SIM do të mbulojë të gjitha fushat dhe tematikat mjedisore si: Ajri, Biodiversiteti, Uji, Kimikatet, Emetimet Industriale dhe Mbetjet.

1.3. Rëndësia e SIM

Sistemi i Informacionit Mjedisor është i rëndësishëm sepse mundëson:

- Përpunimin e informacionin nga burim kryesor më i afërt i të dhënave;
- Mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve në të njëjtën kohë, duke e bërë atë të disponueshme për subjektet e tjera dhe përdoruesit për qëllimet e tyre;
- Përmirësimin dhe integrimin e sistemeve ekzistuese të mbledhjes së të dhënave dhe informatave;

- Qasje të lehtë në të dhëna dhe informata me qëllim të ndërmarrjes së masave për mbrojtjen e mjedisit, duke vlerësuar rezultatet e këtyre masave dhe dhënien e informacionit mbi gjendjen e mjedisit për publikun;
- Mbështetjen e nevojshme teknike dhe shkencore për palët dhe institucionet;
- Zbatimi i mjeteve teknike (softuerë) uniforme, standardet e regjistrimit dhe procedurat e transferimit të të dhënave;
- Ndërveprimet teknike (normat dhe standardet për lidhjen e sistemeve kompjuterike dhe shërbime), semantik (njohja e të dhënave) dhe nivelit të procesit (që përcaktojnë objektivat, proceset e modelimit dhe bashkëpunimin në mes të subjekteve raportuese), zbatimin e standardeve teknike kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Hartimin më të shpejtë dhe më efikas të raporteve, analizave dhe studimeve për gjendjen e mjedisit;
- Mundëson vendimmarrjen dhe planifikim më të lehtë nga politikë-bërësit e niveleve të ndryshme;
- Rritë efikasitetin dhe nivelin e bashkëpunimit në mes palëve dhe institucioneve;
- Kursen kohën, materialet teknike dhe resurset humane;
- Rritë transparencën për punën e institucioneve;
- Pajtueshmëri me rregulloret dhe standardet e BE-se.

1. Korniza ligjore dhe Institucionale për SIM

2.1. **Kroniza Ligjore per SIM**

Baza ligjore për hartimin e programit për menaxhimin e Sistemit Informativ Mjedisor është e bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, në Udhëzimin administrativ për Sistemin Informativ Mjedisor dhe në ligjet tjera relevante.

Tabela 1: Baza Ligjore për hartimin e programit për menaxhimin e SIM

Akti ligjor apo nënligjor	**Përshkrimi**
Ligji Nr. 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedisit	**Neni 52-Sistemi i Informimit Mjedisor** 1. Me qëllim të identifikimit, klasifikimit, për-punimit, përcjelljes dhe evidentimit sa më efikas të resurseve natyrore, vlerave të natyrës si dhe menaxhimit të mjedisit në Kosovë, Ministria krijon, organizon dhe mbanë Sistemin Informativ Mjedisor. 2. SIM bënë mbledhjen, klasifikimin, mirëmbajtjen, prezantimin dhe shpërndarjen e të dhënave numerike, përshkruese dhe hapësinore për: cilësinë e mediumeve të mjedisit; përcjelljen e gjendjes së mjedisit; masat ligjore,administrative, organizative dhe strategjike; informatat shkencore-teknologjike për masat e planifikuara për parandalimin e ndotjes; shkëmbimin e informatave me sistemet tjera informative etj.

	3. SIM mundëson qasje në informata sistemeve tjera informative dhe harmonizon te gjitha informatat relevante në nivel të Kosovës dhe në nivelin ndërkombëtar. 4. Ministria me akt nënligjor, përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së SIM, metodologjinë, strukturën, bazat e përbashkëta, kategoritë dhe nivelin e grumbullimit të të dhënave, si dhe përmbajtjen e informacionit me të cilën informohet publiku rregullisht dhe detyrimisht.
Ligji Nr. 02/L-30 për mbeturinave	**Neni 14 pika d:** Ministria krijon bazën e shënimeve dhe sistemin informativ për administrimin e mbeturinave.
Ligji nr. 04/L-197 për kemikate	**Neni 15 - Sistemi informues për kimikatet** 1. Shkëmbimi i informacioneve me institucionet e BE-së dhe ato ndërkombëtare për kimikatet bëhet duke u bazuar në dispozitat e dokumenteve të ratifikuara nga organi kompetent i Republikës së Kosovës. 2. Mbledhja, përpunimi, ruajtja dhe shkëmbimi i informacioneve me institucionet vendore për kimikatet është detyrë e Ministrisë, duke u bazuar në dispozitat e këtij ligji lidhur me detyrimet për informim mbi kimikatet. 3. Ministria informon publikun dhe autoritetet përkatëse për rreziqet që mund të rrjedhin nga përdorimi I substancave dhe përzierjeve të rrezikshme dhe të rekomandojë marrjen e masave të nevojshme për zvogëlimin e rrezikut. 4. Ministria nxjerr dhe publikon udhëzime teknike për nevojat e informimit të publikut dhe publikon regjistrat e substancave dhe përzierjeve që janë të nevojshme për zbatimin e këtij ligji.
Ligji NR. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës	**Neni 72** Instituti për Mbrojtjen e Natyrës mban sistemin informativ e të dhënave të mbrojtjes së natyrës si pjesë e sistemit të përbashkët informativ të MMPH, sipas standardeve dhe detyrimeve ndërkombëtare të pranuara.
Ligji nr. 08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja	**Neni 44 Përmbajtja e Sistemit Informativ për Ajër** 1.Sistemi Informativ për Ajër është pjesë e Sistemit Informativ Mjedisor i cili zbatohet sipas ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit. 3. Institucionet e nivelit qendror dhe lokal, personat juridik të cilët kanë autorizim, janë të obliguar të ia dërgojnë AMMK të dhënat e nevojshme për përditësimin e Sistemit Informativ të Ajrit dhe për hartimin e planit, programit dhe raportit. 4. Sistemi Informativ për Ajër përshtatet dhe ndërlidhet me sistemet informative të cilat i menaxhojnë institucionet tjera qendrore,dhe lokal dhe personat juridik të autorizuar nga institucionet. 5. Institucionet e nivelit qendror dhe lokal si dhe personat juridik të autorizuar nga institucionet, të cilët posedojnë të dhënat me rëndësi për menaxhimin e cilësisë së ajrit dhe udhëheqjen e Sistemit Informativ të Ajrit, janë të obliguar t'a dërgojnë AMMK në formë elektronike. **Neni 45 Informimi i publikut**

	Neni 46 Shkëmbimi i informatave 1. Të dhënat nga Sistemi Informativ për Ajër, përdoren për shkëmbimin e informatave, për të dhënat nga rrjeti për monitorimin e cilësisë së ajrit si dhe të dhënat për rrjetin, stacionet dhe teknikave të matjes si dhe për raportimin vjetor për vlerësimin e cilësisë së ajrit. 2. Të dhënat nga Sistemi Informativ për Ajër përdoren për ofrimin e informatave për planet si dhe të dhënat për emisionet nga burimet e ndotjes së ajrit, për nevojat e raportimit sipas marrëveshjeve ndërkombëtare. **Neni 47 Qasja në informata**
Ligji Nr.04/ L-147 për ujërat e Kosovës	**Neni 81 - Sistemi Informativ ujor** 1. Sistemi Informativ Ujor përfshinë masat dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me regjistrimin, transferimin, mbrojtjen, shfrytëzimin e të dhënave si dhe çështjet e tjera me rëndësi për administrim me ujëra. 2. Sistemi informativ ujor përfshin të d hënat për: 2.1. sasinë dhe cilësinë e ujërave; 2.2. protokollin ujor dhe kadastrat e sistemit ujor; 2.3. protokollin e të gjitha lejeve; 2.4. regjistrin e substancave të shkarkuara nga bartësi i lejes ujore; 2.5. masat për rehabilitimin dhe programet për mbrojtjen e ujërave; 2.6. incidentet e dëmtimit të ujërave dhe aksidentet mjedisore; 2.7. regjistrin e materieve të dëmshme dhe të rrezikshme, në resurset ujore; 2.8. aktivitetet që janë të rrezikshme për shëndetin publik dhe mjedisin; 2.9. analizat e ndikimeve të materieve të rrezikshme; dhe 2.10. regjistrin më të dhënat e ndërtimeve, instalimeve apo deponive ekzistuese që janë të rrezikshme; 2.11. raportim për gjendjen e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. 3. Të gjithë personat dhe institucionet, janë të detyruara të ofrojnë të dhëna për ujërat Ministrisë dhe autoriteteve kompetente për ujëra. 4. Të dhënat e Sistemit informativ ujor janë publike dhe çdo kush mund të ketë qasje në to, përveç të dhënave që konsiderohen sekret shtetëror. 5. Ministria, me akt nënligjor, përcakton më hollësisht punën, mënyrën dhe çështjet tjera me rëndësi për sistemin informativ ujor.
Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma	**Neni 9** – Hartat Strategjike të Zhurmës • Qeveria dhe komunat duhet të hartojnë: Hartën strategjike të zhurmës; • Hartat strategjike të zhurmës nga paragrafi 1 i këtij neni janë pjesë përbërëse e sistemit informativ të mbrojtjes së mjedisit të Kosovës dhe paraqesin bazë profesionale për hartimin e planeve hapësinore.
Ligji Nr.08/L-145, për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes	Neni 25 Qasja në informata dhe pjesëmarrja e publikut në procedurën e lëshimit të lejes
Udhëzimi administrativ nr.	• Neni 25- Mënyra e dorëzimit të të dhënave nga operatorët,

17/2013, për kadastrin e shkarkimeve të ndotësve mjedis	• Neni 28-Mënyra e përpunimit të të dhënave nga AMMK, • Neni 29- Sigurimi dhe kontrolli i cilësisë së të dhënave dhe • Nenet 30 e 31-Afati dhe mënyra e informimit të publikut.
Rregullore (MAP) nr. 02/2015 për standarde për softuer dhe harduer	• Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i standardeve të përdorimit të softuerit dhe harduer nga zyrtarët e institucioneve të Republikës së Kosovës.
Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 Për Ueb Faqet e Institucioneve Publike	• Ky udhëzim administrativ përcakton standardet për formën, përmbajtjen minimale, pamjen vizuele, dhe Minister of the Ministry of Public Administration
Udhëzim Administrativ nr. 02/2010 për Menaxhimin e Sigurisë Informative	• Ky Udhëzim Administrativ përcakton mënyrën e menaxhimit të sigurisë së informatave nga personat përgjegjës për zbatimin dhe mirëmbajtjen e sigurisë informative në institucionet e Republikës së Kosovës.

Programi për menaxhimin e SIM, është i mbështetur dhe është në funksion të zbatimit edhe të Strategjive, Planeve dhe Programeve relevante për sektorin e mjedisit.

Tabela 2: Strategjitë, Planet dhe Programet në sektorin e mjedisit dhe sektorët relevante për SIM

Strategjia/Plani	Periudha e vlefshmërisë	Statusi i dokumentit	Institucioni përgjegjës për zbatim
Strategjia për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm[1].	2022-2030	Dokumenti është Draft fillestar.	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave	2021- 2030	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019- 2028 dhe Plani i Veprimit për për Ndryshimet Klimatike 2019- 2021	2019-2028	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministritë respektive
Rishikimi i Strategjisë shtetrore te ujërave dhe Plani i Veprimit dhe investimeve në ujëra	2023-2028	Duhet të aprovohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nga Kuvendi i Kosovës	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Programi i Monitorimit të Ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	2014-2015	Aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Plani Hapësinor i Kosovës- Strategjia për Zhvillimin	2010-2020+	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

[1] *Sqarim: Në Strategjinë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillim të Qëndrueshëm përfshihen Strategjia e Mjedisit, Strategjia e Ajrit, Strategjia e Biodiversitetit dhe Strategjia e hidrometeorologjis dhe Planet e Veprimit.*

Hapësinor të Kosovës			
Strategjia e Energjisë së Kosovës	2022-2031	Miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Ekonomisë
Draft Programi për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë së Kosovës	2022-2024	Dokumenti është Draft	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Planit per Energji dhe Klimë	2025-2030	Dokumenti është Draft	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Strategjia afatgjate për Dekarbonizim	2024 - 2033	Dokumenti është Draft fillestar	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Strategjia e Zhvillimit të Pylltarisë	2021-2030	Miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Strategjinë për menaxhimin e kimikateve në Republikën e Kosovës.	Strategjia hartohet për një periudhë kohore dhjetë (10) vjeçare,	Neni 17 i ligjit per kemikate: Strategjia për menaxhimin e kimikateve 1. Ministria, harton Strategjinë për menaxhimin e kimikateve në Republikën e Kosovës. Dokumenti duhet të miratohet nga Qeveria.	Ky dokument duhet te pergaditet nga MMPHI (Dokumenti ende nuk eshte nxjerre nga Ministria).

Kosova ende nuk është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe as e Bashkimit Evropian. Aktualisht ajo nuk ka obligime për përmbushjen e Konventave, Protokolleve dhe Direktivave dhe marrëveshjeve tjera ndërkombëtare, mirëpo meqenëse është e përcaktuar në rrugën e integrimeve Evropiane dhe anëtarësimit në OKB dhe në institucionet vartëse të saj, atëherë duhet marrë për bazë edhe legjislacionin dhe obligimet ndërkombëtare që ndërlidhen me Sistemin Informativ Mjedisor.

Konventat ndërkombëtare me rendësi për SIM janë:

- Konventa e UN për Ndryshimet Klimatike-UNFCC (1992)
- Konventa e UN për Diversitetin Biologjik (1993)
- Konventa e Aarhusit- Konventa e UNECE për Qasje në Informim, pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje dhe dhe Qasje në Drejtësi për çështje mjedisore (1998) dhe Protokolli për Regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve (PRTR).
- Konventa e Stokholmit- Konventa e OKB për mbrojtjen e shëndetit të njeriut nga ndotësit e qëndrueshëm organik (1995).
- Konventa LRTAP- Konventa e UNECE për ndotje ndërkufitare të ajrit me rreze të gjatë veprimi (1979.)

Protokollet ndërkombëtare më rëndësi për SIM janë:

- Protokolli i Montrealit - Protokoli i OKB-së, për Substancat që hollojnë shtresën e Ozonit (1989).
- Protokolli i UNECE për PRTR- Regjistrin e Shkarkimeve dhe Ndotësve në Mjedis (2009).
- Konventa për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhave Ujore Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare (Konventa e Wat) dhe Protkolli i saj për Ujërat dhe Shëndetin.

Direktivat dhe Rregulloret e Bashkimit Evropian më Rëndësi për SIM janë:

- Direktiva 2003/4/EC, për qasje në informata mjedisore (2003).
- Direktiva 2008/50/EC, për cilësinë e ajrit ambiental dhe ajër të pastër (2008).
- Direktiva 1996/62/EC për vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit (Direktiva Kornizë për Cilësi të ajrit)(1996).
- Rregullorja Nr.401/2009 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, për Agjencinë ne Mjedisit të Evropës dhe për Rrjetin Mjedisor Evropian për Informim dhe Vëzhgim. (2009).
- Rregullorja (EC) 166/2006 në lidhje me themelimin e Regjistrit Evropian të Shkarkimeve dhe Ndotësve (E-PRTR) (2006).
- Direktiva 2007/2/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian, për themelimin e Infrastrukturës për të dhëna hapësinore për Komunitetin Evropian (INSPIRE) (2007).
- Komunikimi SEC (2008) 111 dhe SEC (2008) 112, nga Komisioni Evropian për Këshillin dhe Parlamentin Evropian, për themelimin e Sistemit të Përbashkët për Informim Mjedisor (SEIS).

2.2. Roli i AMMK në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e SIM

Sipas nenit të 60 të Ligji Nr. 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedisit, detyrat e AMMK që ndërlidhen me SIM janë:

- të siguroj informacionin e duhur për administratën, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës për zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit:
- të zhvilloj dhe koordinoj sistemin unik të informimit për mbrojtjen e mjedisit lidhur me sistemin e përcjelljes së gjendjes së mjedisit në Kosovë si dhe të mbledhë të dhënat për mjedisin;
- ti vendosë dhe ti mbajë qendrat referente me bazat e të dhënave për përcjelljen e mjedisit (të dhënat socio-ekonomike, presionet në mjedis, gjendjen dhe kualitetin e mjedisit);
- të zhvillojë procedurat për përpunimin e të dhënave të grumbulluara për mjedisin dhe vlerësimin e tyre (modelimin, prezantimin dhe paraqitjen vizuele);
- të kryej punët profesionale gjatë përcaktimit të përmbajtjes, metodologjisë dhe mënyrës së përcjelljes të gjendjes së mjedisit.
- të avancojë dhe krahasojë cilësinë e të dhënave për mjedisin.

Sipas nenit 7 të Udhëzimi Administrativ nr. 07/2016 për Sistemin e Informimit Mjedisor thuhet:

Për krijimin, menaxhimin, zhvillimin, koordinimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit unik të informimit, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës:

- Zhvillon programin për menaxhimin e Sistemit Informativ në bashkëpunim me institucionin tjera përgjegjëse të Qeverisë së Kosovës dhe në harmoni me dokumentet tjera strategjike dhe programore për menaxhimin e të dhënave;
- Zhvillon listën kombëtare të treguesve mjedisorë, zhvillon dhe administron Sistemin Informativ,
- Jep rekomandime për harmonizimin e Sistemit Informativ me sistemet e informimit të sesioneve tematike dhe nën-seksioneve përkatëse duke përfshirë të dhënat dhe të dhënat për të dhënat (metadata);
- Propozon masa për harmonizimin dhe përfshirjen e Sistemit Informativ në Sistemin Evropian për shkëmbimin e të dhënave mjedisore,
- **J**ep propozime për pajiset e teknologjisë informative (IT), softuerë dhe pajisje tjera të komunikimit të nevojshme për Sistemin informativ,
- Monitoron dhe jep rekomandime për qasje në të dhënat dhe informatat për mjedisin.

2.3. Institucionet prodhuese të të dhënave mjedisore

Bazuar në përgjegjësitë ligjore dhe institucionale në Kosovë, ka institucione të ndryshme që prodhojnë të dhëna mjedisore për sektorë të ndryshëm. Në tabelën 6 janë prezantuar institucionet që prodhojnë të dhëna mjedisore, llojin i të dhënave si dhe formatin dhe frekuencën e prodhimit të dhënave.

Tabela 3. Institucionet dhe organizatat që prodhojnë të dhëna për SIM

Institucioni/organizata	Lloji i të dhënave	Formati i ofrimit te te dhënave[2]	Frekuenca
AMMK/Drejtoria për Monitorim, Vlerësim dhe Raportim	• Te dhënat për inventarin e gazrave serrë	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat për inventarin e emisioneve në ajër.	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat për mbulushmërinë e tokës (Corine Land Cover).	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat mjedisore në formatin GIS.	A dhe D	Sipas nevojës
	• Harta Strategjike e Zhurmës	A dhe D	5 vjeçare
AMMK/Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës	• Cilësia e ajrit	A dhe D	Mujore
	• Cilësia e ujërave sipërfaqësore	A dhe D	Mujore
	• Cilësia e ujërave nëntokësore	A dhe D	Mujore
	• Sasia e ujërave sipërfaqësore	A dhe D	Mujore
	• Cilësia e dheut/tokës	A dhe D	Periodike
	• Të dhënat për reshjet • Të dhënat për temperaturën e ajrit	A dhe D	Mujore
AMMK/Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës	• Të dhënat për zonat e mbrojtura të natyrës	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat për biodiversitetin (llojet e rrezikuara të bimëve dhe shtazëve).	A dhe D	5 Vjetore
Instituti i Planifikimit Hapësinor	• Të dhënat për planet hapësinorë dhe urbane.		Vjetore
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës	• Të dhënat për ligjet, aktet nënligjore, programet, strategjitë, planet dhe projektet në sektorin e mjedisit.	A dhe D	Vjetore
Ministria e Ekonomisë	• Prodhimi dhe konsumi i energjisë	A dhe D	Vjetore
	• Burimet e ripërtrishtme të Energjisë	A dhe D	Vjetore
	• Eficienca e Energjisë.	A dhe D	Vjetore

[2] *Formati A-Analog dhe Formati D-Dogjital*

	• Energjia primare/intensiteti energjetik	A dhe D	Vjetore
	• Shfrytëzimi i energjisë sipas sektorëve ekonomik.	A dhe D	Vjetore
Ministria e Punëve të Brendshme	• Të dhënat për numrin e veturave sipas kategorive.	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat për moshën e automjeteve.	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat për aksidentet në komunikacion.	A dhe D	Vjetore
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	• Të dhënat për tokat bujqësore,	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat për ujitje,	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat për plehrat kimike,	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat për pesticide dhe kemikate tjera (fungicide,herbicide,insekticide etj.)	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat për fondin e kafshëve	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat për bujqësinë organike.	A dhe D	Vjetore
Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë	• Të dhënat për cilësinë e derivate	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat për turizmin (numri i turistëve dhe shtretërve)	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat për numrin e bizneseve.	A dhe D	Vjetore
	• Industritë aktive sipas sektorëve.	A dhe D	Vjetore
Agjencioni Kadastral i Kosovës	• Të dhënat kadastrale.	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat mjedisore në GIS.	A dhe D	Sipas nevojës
Agjencia e Statistikave të Kosovës	• Të dhënat statistikore për: Rritja e popullsisë, Konsumi, Zhvillimi ekonomik/GDP, Gjenerimi i mbeturinave, Prodhimi, Tregtia, Shërbimet, Bujqësia,	A dhe D	Vjetore
Agjencia e Pyjeve i Kosovës	• Të dhënat për prerjet e pyjeve.	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat për sipërfaqet djegura (zjarret) në pyje.	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat për sipërfaqet e pyllëzuara.	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat për sipërfaqet e tokave pyjore.	A dhe D	Vjetore
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	• Të dhënat për minierat dhe gurthyesit/baza të asfaltit, llojet dhe kategoritë e tyre, kapacitetin dhe ndikimet në mjedis	A dhe D	Vjetore
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës	• Të dhënat për cilësinë e ushqimit.	A dhe D	Vjetore
Agjencia për Siguri Bërthamore dhe Rrezatim Jonizues	• Të dhënat për rrezatim jonizues dhe jo-jonizues.	A dhe D	Vjetore
Agjencia e Emergjencave	• Të dhënat për fatkeqësitë dhe emergjencat natyrore	A dhe D	Vjetore
Doganat e Kosovës	• Të dhënat për importin-eksportin e kemikateve.	A dhe D	Vjetore

	• Të dhënat për importin eksportin e substancave që hollojnë shtresën e Ozonit (FCF).	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat për sasitë e karburanteve	A dhe D	Vjetore
	• Te dhena per importin-eksportin e mbeturinave	A dhe D	Vjetore
Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik	• Sëmundjet mjedisore	A dhe D	Vjetore
	• Ndikimi i mjedisit në shëndetin publik	A dhe D	Vjetore
	• Kualiteti i ujit të pijes	A dhe D	Vjetore
ARRU - Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit.	• Mblushmëria me shërbimin e ujësjellësit	A dhe D	Vjetore
	• Mbulushmëria me shërbimin e kanalizimit	A dhe D	Vjetore
	• Tarifat për shërbimet e ujërave dhe kanalizimeve.	A dhe D	Vjetore
	• Sasia e ujit të shpenzuar për pije nga ujësjellësit publik.	A dhe D	Vjetore
KMDK - Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës.	• Sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare.	A dhe D	Vjetore
	• Gjendja e deponive sanitare.	A dhe D	Vjetore
Komunat e Kosovës	• Të dhënat mjedisore në nivelin lokal (mbeturinat, deponite ilegale, etj).	A dhe D	Vjetore
Operatorët ekonomik	• Shkarkimet ndotëse në ujëra	A dhe D	Vjetore
	• Shkarkimet ndotëse në ajër	A dhe D	Vjetore
	• Shkarkimet ndotëse në tokë	A dhe D	Vjetore
	• Sasia e ujit të shpenzuar	A dhe D	Vjetore
	• Mbetjet nga operatorët ekonomik	A dhe D	Vjetore
Instituti Bujqësor i Kosovës	• Të dhënat nga kontrolli i cilësisë së inputeve bujqësore, ushqimit dhe tokës.	A dhe D	Vjetore
	• Të dhënat nga hulumtimi, identifikimi dhe inventarizimi agjentëve të dëmshëm biologjik.	A dhe D	Vjetore
Agjencioni për produkte dhe pajisje medicinave	• Të dhënat për produktet farmaceutike (barërat) me afat të skaduar.	A dhe D	Vjetore
Qendrat regjionale spitalore të Kosovës	• Te dhënat për mbeturinat spitalore	A dhe D	Vjetore
	• Te dhënat për trajtimin e mbeturinave spitalore	A dhe D	Vjetore

Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave nga institucionet relevante, aty ku është e mundur do të kërkohet të ofrohen të dhënat të ndara sipas gjinisë, moshës dhe vendndodhjes.

3.1. Shfrytëzuesit e të dhënave të SIM

Të dhënat e prodhuara mjedisore që janë pjesë e SIM, shfrytëzohen nga kategori dhe nivele të ndryshme të institucioneve dhe organizata dhe nga publiku i gjerë. Në tabelën 7 janë prezantuar grupet e ndryshme të institucioneve dhe organizatave shfrytëzuese të të dhenve mjedisore të SIM.

Tabela 4. Shfrytëzuesit e të dhënave nga SIM

Grupet e interesit	**Institucionet/organizatat**
Institucionet e larta vendimarrese të Republikës së Kosovës	- Qeveria e Republikës së Kosovës. - Kuvendi i Republikës së Kosovës. - Presidenti i Republikës së Kosovës.
Ministritë e Linjës	- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës. - Ministria e Ekonomisë. - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. - Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë; - Ministria Shëndetësisë. - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. - Ministria e Punëve të Brendshme. - Ministria e Forcës së Sigurisë. - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
Agjencitë dhe institucionet tjera të pavarura në nivelin nacional	- Agjencia e Statistikave të Kosovës. - Agjencioni Kadastral i Kosovës. - Agjencia e Pyjeve të Kosovës. - Agjencia për Siguri Nukleare dhe Rrezatim Jonizues. - Agjencia për Eficencë të Energjisë. - Agjencia e Emergjencave. - Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. - Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik. - Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit. - Doganat e Kosovës. - Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës. - Zyra e Avokatit të Popullit.
Kompanitë dhe organizatat e nivelit regjional	- Kompanitë Regjionale të Mbeturinave. - Kompanitë Regjionale të Ujërave.
Pushteti Lokal	- Komunat e Kosovës.
Institucionet shkencore dhe akademike	- Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës. - Universitetet Publike. - Universitetet Private. - Institutet kërkimore shkencore.
Organizatat e shoqërisë civile dhe grupet tjerë nga publiku si dhe publiku i gjerë	- Organizatat Jo Qeveritare Mjedisore. - Rrjetet e organizatave joqeveritare mjedisore; - Organizat për mbrojtjen e të drejtave të grave; - Rrjeti i organizatave të grave të Kosovës.

	- Asociacionet. - Fondacionet. - Ekspertët e pavarur. - Publiku i gjerë.
Institucionet Ndërkombëtare	- Agjencia e Mjedisit të Evropës EEA. - Rrjeti Evropian Mjedisor për Monitorim dhe vëzhgim/EIONET. - Agjencia e Statistikave të Evropës-Eurostat. - Bashkimi Evropian. - Komisioni Evropian (Drejtoria Gjenerale për Mjedis dhe Klimë). - Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe trupat e saj (UNEP, UNDP, UNECE, UNICEF, UN Women). - Banka Botërore; - Unioni Ndërkombëtarë për Konservimin e Natyrës (IUCN)
Përfaqësitë diplomatike, donatorët dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë	- Donatorët (BE, GIZ, SIDA, JICA, USAID, etj.). - Përfaqësitë diplomatike (ambasadat) e akredituara në Kosovë. - Përfaqësitë e organizatave ndërkombëtare në Kosovë (Zyra e UNDP, Zyra e BE, Zyra e OSBE, Zyra e OBSH etj).

4. Struktura dhe organizimi i SIM

4.1. Grupet themelore të SIM

SIM është i organizuar në këto grupe themelore:

- Përbërësit mjedisor;
- Presionet sektoriale në mjedis;
- Ndikimet në shëndetin dhe sigurinë e njerëzve[3];
- Reagimet e shoqërisë ose masat dhe veprimet e ndërmarra.

Në kuadër të secilit nga këto grupet themelore janë të përfshira grupet tematike dhe nëngrupet të cilat e përbëjnë tërësinë e Sistemit Informativ Mjedisor (Tabela 5).

Kjo strukturë e Sistemit Informativ Mjedisor është e përshkruar në nenin 4 pika të të Udhëzimit Administrative për Sistemin e Informimit Mjedisor dhe në shtojcën përkatëse të këtij udhëzimi.

Gjithashtu kjo strukturë është përshtatur edhe sipas nevojave të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të të dhënave mjedisore me Agjencitë e Mjedisit të Evropës (AME-EEA) dhe me Rrjetin Evropian për Informim dhe Vëzhgim (RREIV-EIONET).

Tabela 5: Grupet themelore, grupet dhe nëngrupet tematike të SIM

Grupet themelore të SIM	Grupet tematike	Nëngrupet tematike
